



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë, më 04.06.2022

**Dokument Parlamentar**  
*(Komision përgjegjës)*

**RAPORT**

**PËR SHQYRTIMIN E KANDIDATURËS PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË VOTIMIN E RAUNDIT TË KATËRT,  
DATË 04 QERSHOR 2022**

**I. HYRJE**

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në seancat plenare të datave 16 maj 2022, 23 maj 2022 dhe 30 maj 2022, përmbylli procedurat parlamentare për votimin e raundit të parë, të dytë dhe të tretë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të cilat rezultuan pa kandidatë.
2. Në zbatim të nenit 87, pika 2 e Kushtetutës dhe nenit 109, pika 3 e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Konferenca e Kryetarëve u mbledh më datë 31 maj 2022, e cila me anë të vendimit nr. 13, datë 31.05.2022, caktoi datën 4 qershor 2022, ora 18.00, për zhvillimin e raundit të katërt të votimit për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës së Shqipërisë.
3. Në përmbushje të përcaktimeve të vendimit nr. 13, datë 31.05.2022 të Konferencës së Kryetarëve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (Komisioni), mbledhet në orën 16.00 të datës 4 qershor 2022 dhe paraqet raportin e tij për seancë plenare.
4. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u mbledh sot më datë 4 qershor 2022, ora 16.00, në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve

dhe bazuar në Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin e kandidaturave për President të Republikës të depozituara në Kuvendin e Shqipërisë.

5. Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, për zhvillimin e raundit të katërt të votimit, është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë kandidatura e Z. Bajram Rushit Begaj.
6. Kandidatura e Z. Bajram Begaj është paraqitur nga 37 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, në përputhje me parashikimet e nenit 86, pika 2 dhe nenit 87, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 109 të Rregullores së Kuvendit.

## **II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

#### **Neni 86**

1. Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.
2. President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

#### **Neni 87**

1. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të propozojë në të njëjtën kohë më shumë se një kandidat.
2. Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi. Për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime. Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni.
3. Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin katërt dhe të pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
4. Votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short. Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat në konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi zhvillohet midis dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të lartë të deputetëve propozues.

5. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij.

6. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

## **Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë**

### **Neni 109**

#### **Zgjedhja e Presidentit të Republikës**

1. Presidenti i Republikës zgjidhet në përputhje me nenet 86, 87 dhe 88 të Kushtetutës, me votim të fshehtë dhe pa debat. Konferenca e Kryetarëve cakton datën e kryerjes së votimit për çdo raund votimi të përcaktuar në Kushtetutë. Sekretariati për Procedurat dhe Votimet është komisioni i votimit, i cili në këtë rast organizon dhe shpall publikisht rezultatin e votimit.

2. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut shqyrton nëse kandidatët për president i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Kushtetutë dhe i paraqet raportin seancës plenare, sipas afatit të përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve.

3. Presidenti i Republikës zgjidhet me një shumicë prej jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit në votimin e parë, votimin e dytë ose votimin e tretë. Në votimin e katërt dhe në votimin e pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit, sipas nenit 88 të Kushtetutës. Në rast se në votimin e parë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë. Për votimin e dytë dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë, ose kur kandidati që ata propozuan në votimin e parë është tërhequr. Në rast se në votimin e dytë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e kryerjes së votimit të tretë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të dytë. Për votimin e tretë dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë ose të dytë, ose kur kandidati që ata propozuan në votimin e parë ose të dytë është tërhequr. Në rast se në votimin e tretë nuk arrihet shumica prej tri të pestave të votave, Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e votimit të katërt, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të tretë. Për votimin e katërt dhe sipas pikës 2 të këtij neni mund të paraqiten kandidatë të rinj nga jo më pak se 20 deputetë, që s'kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimet pararendëse, ose kur kandidati që ata propozuan në votimet pararendëse është tërhequr. Në rast se në votimin e katërt nuk arrihet shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, Konferenca e Kryetarëve cakton menjëherë datën e votimit të pestë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të katërt. Votimi i pestë zhvillohet mes dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votimin e pestë caktohet me short. Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat

për konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të nenit 87 të Kushtetutës dhe pikës 2 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi i pestë zhvillohet mes dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të madh të deputetëve propozues.

4. Në rast se edhe në votimin e pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kryetari i Kuvendit shpall shpërndarjen e Kuvendit. Kuvendi pasardhës zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

### **III. JETËSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I Z. BAJRAM BEGAJ**

Z. Bajram Begaj ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Mjekësi” në vitin 1998. Gjatë karrierës së tij ushtarake Z. Bajram Begaj ka kryer “Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen”, në Shqipëri, “Shkollën e thelluar pasuniversitare të mjekësisë”, në Shqipëri, “Specializimin Pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji”, në Shqipëri, “Kursin e menaxhimit spitalor” dhe “Kursin e lidërshpimit mjekësor strategjik”, në SHBA; “Specializimin në fushën e mjekësisë” dhe “Kursin e Shëndetësisë”, në Greqi;

Z. Bajram Begaj ka përfunduar “Doktoraturën në Fushën e Mjekësisë”, në Shqipëri si dhe mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi.

Z. Bajram Begaj ka kryer detyra të ndryshme si: “Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes”, “Shef i Njesisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendës drejtor Ushtarak i SUT”, “Drejtor i Spitalit Ushtarak”, “Drejtor i Inspektoratit Shëndetësor” dhe “Kryeinspektor dhe Këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, “Shef i Shërbimit të Gastrologjisë” dhe “Shef i Shërbimit Ambulator, në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar”, “Drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar”, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 11535, datë 03.07.2020 “Për dhënie grade madhore”, Z. Bajram Begaj është graduar “Gjeneralmajor”.

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 11572, datë 29.07.2020 “Për emërim në detyrë”, Z. Bajram Begaj është emëruar “Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.

Gjeneral major Z. Bajram Begaj flet rrjedhshëm gjuhën angleze. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë.

### **IV. PËRMBUSHJA E KRITEREVE KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

*A - Nga ana juridike formale - procedurale:*

Kandidatura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës e paraqitur për shqyrtim është propozuar nga 37 deputetë në përmbushje të përcaktimeve ligjore të neneve 86, pika 2 dhe 87, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (pra nga më shumë se 20 deputetë, që parashikon dispozita kushtetuese), dhe sipas procedurës të parashikuar në nenin 109 të Rregullores së Kuvendit si dhe brenda afatit të parashikuar në vendimin nr. 13, datë 31.05.2022 të Konferencës së Kryetarëve.

*B – Mbi përmbushjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore :*

Referuar dokumentacionit që administroi Komisioni, kandidati për President i Republikës Z. Bajram Begaj plotëson kërkesat kushtetuese, ligjore si dhe ato lidhur me integritetin dhe figurën për të qenë President i Republikës.

i. Kandidati për President, Z. Bajram Begaj plotëson kushtet e parashikuara në nenin 86, pika 2 të Kushtetutës, ku shprehimisht parashikohet: *“President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.”*, pasi:

1. Është shtetas shqiptar nga lindja dhe rezulton se nuk ka hequr dorë asnjëherë nga shtetësia shqiptare;
2. Ka lindur më 20 mars 1967, në Rrogozhinë, duke plotësuar kriterin e moshës përcaktuar në dispozitën kushtetuese;
3. Ka patur qëndrim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë 10 viteve të fundit.

ii. Në aspektin ligjor, Z. Bajram Begaj nuk ka asnjë pengesë ligjore për të qenë kandidat për President, pasi nuk ndodhet në asnjë nga rastet ndaluese që parashikohen në Ligjin Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

1. Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në dokumentacionin shoqëruar të Z. Bajram Begaj, konstatohet se ka paraqitur deklaratë me të cilën deklaron nën përgjegjësinë personale se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para datës 2 Korrik 1991.

2. Me shkresën nr. 957/1, datë 04.06.2022, të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, vërtetohet se Z. Bajram Begaj, nuk ka asnjë pengesë ligjore të parashikuar nga Neni 29, pika 1, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Nga dokumentacioni shoqërues konstatohet se Z. Bajram Begaj, në zbatim të nenit 5, pika 1 e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, ka plotësuar dhe nënshkruar formularin e vetëdeklarimit.
4. Formulari i vetëdeklarimit rezulton i administruar pranë Kryetarit të Kuvendit në dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati Z. Bajram Begaj, administruar me nr. 2084, prot, datë 04.06.2022, sipas kërkesës ligjore të parashikuar në Nenin 5, pika 4, shkronja b) të Ligjit Nr. 138/2015.
5. Gjeneral major Bajram Begaj, gëzon një reputacion të spikatur në shoqëri si një personalitet me integritet të lartë etiko - moral dhe profesional dhe përfaqëson të gjitha vlerat për të qenë kandidat për President.
6. Bazuar në detyrimin kushtetues përcaktuar në nenin 167, pika 1 të Kushtetutës, i cili parashikon se ushtarakët e shërbimit aktiv, nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore, Komisioni konstatoi se z. Begaj ka dhënë dorëheqjen nga detyra e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura më datë 04.06.2022. Në vijim, me propozim të Kryeministrit përcjellë me shkresën nr. 3236/3, prot., datë 04.06.2022, Presidenti i Republikës z. Ilir Meta, me dekret nr. 13647, datë 04.06.2022 ka dekretuar lirimin e z.Bajram Begaj nga detyra e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe nxjerrjen në lirim nga shërbimi aktiv në Forcat e Armatosura. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

## **V. PËRFUNDIME**

Në zbatim të pikës 2, të nenit 109, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut konstaton se Z. Bajram Begaj plotëson:

1. Kriteret formalo-juridike të përcaktuara në nenin 86, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, dhe nenin 29, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e

Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socilaiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe që shoqëron raportin si dhe në verifikimet e mësipërme, bazuar në rregullat e parashikuara në nenin 87, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 109, pika 3 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Kuvendi i Shqipërisë në seancë plenare dhe pa debat, duhet të vijojë me zhvillimin e raundit të katërt të votimit për President të Republikës, me kandidaturën e Z. Bajram Begaj.

Bashkëlidhur, raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ju lutem gjeni dokumentacionin shoqërues të Z. Bajram Begaj, Kandidat për President të Republikës.

**Relator**

**EDUARD NDRECA**

**Kryetare**

**KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)**